

STATUTI I SHOQERISE

SOUTH AMERICA TRADE BUSINESS Sh.p.k

Sipas ligjit Nr. 9901, te dates 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligji n.9723 te dates 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " eshte themeluar shoqeria si vijon:

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

NENI 1. Eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) e emertuar **SOUTH AMERICA TRADE BUSINESS Shpk**, me ortak:

1. Zj. Paola Vanesa Montenegro Teran, lindur me 12.09.1978, ne Maracaibo, Venezuela, banues ne: Itali, Via Zagora, 38, La Spezia, mbajtes i ID Nr.. AV 8723432, zoterues i 100% te kapitalit te shoqerise

SELIA

NENI 2. Shoqeria me seli ne Tirane, Njesia bashkiake Farke, prane Kopshtit Zoologjik, Rr. Eduart Mano, P.1, Ap.8.

Shoqeria mund të krijojë apo te perfshije seli sekondare, te krijojë dege, filiale dhe zyra brenda dhe jashte kufijve te territorit shqiptar.

KOHEZGJATJA

NENI 3. Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.


Shoqeria mund te shtyje afatin ne baze te normave ligjore.

OBJEKTI

NENI 4. Shoqeria ka per objekt si ne territorin shqiptar dhe jashte saj, per llogari te saj apo te te treteve, ne menyre direkte apo me pjesemarrje:

4.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Shoqeria do te ushtroje aktivitet ne fushen e ndermjetesimit tregtar dhe te konsulences, ne industrine e prodhimit ushqimor ndermjet kompanive europiane me kompanite e tregtimit me pakice dhe importues te medhenj ne Ameriken e Jugut dhe Qendrore. Për më tepër, mbështetja për kompanitë është edhe organizim logjistik, ndihmon në marrëdhëniet midis atyre që blejnë dhe atyre që shesin dhe lehtëson dialogun që dërgimi i mallrave të jetë sa



më i thjeshtë. Së fundi, ajo mbështet me konsulence kompanitë prodhuese në regjistrimin e produkteve të tyre në ministritë e shëndetësisë të vendeve të Amerikës së Jugut.

Shoqeria mund të kryejë cdo lloj veprimesh dhe operacionesh te nevojshem per mbarevajtjen e qellimeve te shoqerise, perfshire ekzekutimin e dhenies se garancise, hipoteka, dhe cfaredolloj garancie personale dhe reale te te treteve perfshire institucione bankare dhe financiare, krijimin e financimeve te perbashketa pasive edhe me garanci reale, marrjen ne pergjegjesi direkte apo indirekte te pjesmarrjeve ne shoqeri te tjera kapitale duke patur nje objekt analog, me qellim kompletimi.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5. Kapitali themeltar eshte 10.000,00 lekë (dhjetemije leke), i ndare ne 1 kuote si me poshte:

1. Zj. Paola Vanesa Montenegro Teran, 1 kuote me vlere 10.000 leke

Kapitali do te derdhet teresisht me krijimin e shoqerise. Asambleja mund te marre vendim per rritje te kapitalit, duke percaktuar afatin, kushtet dhe modalitetet. Kapitali mund te shtohet nepermjet akordimit te pasurive ne natyre apo kredite.

Ne interesin financiar te shoqerise ortaku mund te kryeje derdhje pa interes ne llogari kapitale, si edhe financime me apo pa interes, duke respektuar me perpikmeri ligjin.

Shoqeria mund te procedoje me rimbursime te financimit qofte te pjesshme apo totale; mbledhjen e fondeve nga ortaket, me te drejte rimbursimi, duhet tu drejtohet ekskluzivisht subjekteve qe jane ne perputhje me kerkesat e ligjit dhe rregulloreve, sipas rregullave te autoriteteve perkatese.


ASAMBLEJA

NENI 6. Asambleja thirret ne rastet dhe menytrat e parashikuar nga ligji ne seline e shoqerise apo ne cdo lloj vendi tjeter, me lajmerim apo thirrje edhe ne Shqiperi, sipas zgjedhjes se Organit Administrativ.

Asambleja mund te thirret gjithashtu edhe nepermjet postes elektronike, me dergimin e lajmerimit te pakten tete dite para caktimit te mbledhjes, ne adrese te postes elektronike duke informuar shoqerine dhe i shenuar ne librin e Ortakeve.

Sipas pikes 83.2 te ligjit 9901,dt 14.04.2008 per Tregetaret dhe shoqerite tregtare, ne mungese te thirrjeve te rregullta jane gjithashtu te vlefshme asamblete ne te cilat jane te pranishem te gjithë ortaket e shoqerise.

Ortaku njoftues nepermjet nje prokure te posacme mund te paraqitet ne asamble nga nje person tjeter, sipas kerkesave te percaktuara nga ligji.



NENI 7. Asamblete e zakonshme do te marrin vendime sipas kompetences dhe me shumice te percaktuar nga ligji. Vendimet e marra te adoptuara ligjerisht detyrojne te gjitha ortaket per zbatim, persa kohe nuk nderhyjne apo kundershtojne.

NENI 8. Asambleja e zakonshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor.

Asambleja e zakonshme thirret sa here te jete e nevojshme nga organi administrativ dhe ne te gjitha rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 9. Asamblete drejtohen nga administratori i vetem ose, kur eshte krijuar, nga Keshilli Administrativ, nga vete Presidenti i Keshillit ose, ne mungese te ketyre nga Administratori Delegates. Ne mungesen e tyre ,asambleja do te drejtohet nga personi qe do te paracaktohet nga asambleja.

Presidenti, i shoqeruar nga nje sekretar, ortak apo jo, i percaktuar nga asambleja ,duhet te konstatoje sipas parashikimit rreth pjesmarrjes ne mbledhje.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 10. Administrimi i shoqerise i eshte besuar nje Administratori te Vetem i emeruar per nje periudhe 5 vjecare dhe mund te rizgjidhet dhe revokohet ne perputhje me ligjin. Administratori i vetem eshte **Z. Paola Vanesa Montenegro Teran**.

NENI 11. Administratorit i takon rimbursimi i shpenzimeve te zyres. Percaktimi i kompensimit te administratorit percaktohet nga asambleja, kur kerkohet.


NENI 12. Sapo emerohet, Keshilli Administrativ, thirret nepermjet postes rekomande, apo nepermjet telefaksit, telegramit, postes elektronike sa here qe Presidenti apo nje nga administratoret ta gjykojne te nevojshme, apo nese kerkohet nga te pakten gjysma e administratoreve ne ngarkim. Thirrja duhet derguar te pakten pese dite para dates se percaktuar te mbledhjes, ne rezidencen e keshilltareve apo te kryetareve ose ne studion profesionale ku te lartpermendurit ushtrojne aktivitetin e tyre apo ne telefaksin, ose ne adresen e postes elektronike te cilen posedon shoqeria.

Ne rast urgjence thirrje mund te behet dhe nepermjet telegramit, telefaksit, apo postes elektronike te derguara te pakten nje dite para dates se vendosur te mbledhjes.

Per vlefshmerine e mbledhjes eshte e nevojshme prania e shumices se administratoreve.

Mbledhjet mund te zhvillohen dhe jashte selise se shoqerise.

Lejohet mundesia qe mbledhjet e Keshillit Administrues te mbahen nepermjet telekonferencave apo videokonferencave me kusht qe te gjitha te pranishmit mund te jene te identifikuar,qofte dhe pranimi i tyre per te ndjekur biseden,te nderhyjne ne kohe reale ne trajtimin e argumentave qe po trajtohen,te marrin,te transemtojne dhe te shohin dokumentat. Ne rast te nje supozimi te tille, keshilli do te mbahet ne vendin ne te cilen



ndodhet Presidenti dhe ku duhet te ndodhet gjithashtu Sekretari i mbledhjes, per te lejuar shkrimin dhe nenshkrimin e verbalit.

Ne votim marrin pjese pothuasje te gjitha te pranishmit, ne rast barazie mbizoteron vota e Presidentit.

NENI 13. Nese nominohet, Keshilli Administrues, kur eshte i pranishem, kryesohet nga Presidenti dhe ne rast mungese nga nje Administrator i deleguar, apo nga Administratori me i vjeter ne moshe. Presidenti asistohet nga nje Sekretar i emeruar nga vete Keshilli dhe jashte perberesve te Keshillit.

NENI 14. Administratori i Vetem, ose Keshilli i Administrimit nese nominohet, marrin pushtete administrative qe do te percaktohen nga asambleja ne aktin e emerimit.

NENI 15. Perfaqesimi ligjor i Shoqerise me perdorimin e firmes se shoqerise perkundrejt te treteve i takon Administratorit te vetem ose, ne rastin kur shoqeria drejtohet nga nje Keshill, Presidentit saj dhe administratoreve te deleguar deri ne limitet qe u jane deleguar, ne menyre te pavarur ndermjet tyre. Ata kane mundesine, administratoret e deleguar gjithmone ne limitet e delegimit qe u eshte dhene, te promovojne veprime dhe raste gjyqesore e administrative per cdo lloj shkalle juridiksioni, duke emeruar per kete qellim avokatet.

Administratori Unik dhe/apo Keshilli i Administrates nese nominohet, kane te drejten te emerojne drejtores, po ashtu specialiste te akteve te percaktuara ose kategori aktesh, duke percaktuar kompensimet e tyre. Specialistet do te qendrojne ne krye te detyres deri ne plotesimin e detyres, nese nuk revokohet.

BORDI I SHOQERISE

NENI 16. Nese Asambleja e vendos dhe, ne cdo rast, dhe sipas dispozitave te detyrueshme e ligjore, kontrolli dhe ruajtja e shoqerise do t'i besohet Bordit drejtues, te perbere nga tre anetare efektive dhe dy suplementare, sipas kerkesave konform ligjit.

Anetaret e Bordit emerohen per 3 vite ushtrimore dhe ata mund te rizgjidhen.

Shperblimi i bordit percaktohet nga asambleja per kohen e plote te mandatit dhe gjithsesi nuk mund te jete me i vogel se ai i percaktuar nga detyrimet tarifore profesionale.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 17. Viti ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Organi Administrativ kujdeset, ne perputhje me kohen dhe normat ligjore, per redaktimin e bilancit.

SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI

NENI 18. Per cdo lloj rasti apo shkaqe shperberje te parakoshme te shoqerise, normat per likuidim, emerimi i likuiduesve me fuqite perkatese, do te percaktohen nga asambleja ne perputhje me normat ligjore.

VENDBANIMI I ORTAKEVE

NENI 19. Vendbanimi i ortakut, per marrëdhëniet me shoqerine mendohet te mendohet i percaktuar ne adresen qe rezulton ne librin e ortakeve.

RREGULLA PERFUNDIMTARE

NENI 20. Per c'ka nuk eshte shprehur ne Statutin aktual, i duhet referuar dispozitave te Kodit Civil dhe ligjeve lidhur me to.

Tirane, me 17.11.2021

SOUTH AMERICA TRADE BUSINESS Sh.p.k

ORTAKU I VETEM

PAOLA VANESA MONTENEGRO TERAN

paola Vanesa Montenegro Teran
Paola